



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

Raport Konsultativ rreth Strukturës Tarifore

DEKLARATË

Ky dokument është përgatitur nga ZRRE vetëm për qëllime të konsultimit. Dokumenti nuk paraqet vendim të ZRRE-së.

PËRMBAJTJA:

PASQYRA	2
1. Struktura tarifore dhe tarifat ekzistuese.....	3
2. Konsumi sezonal	5
3. Konsumi ditor	8
4. Pjesëmarrja e kategorive në konsum të përgjithshëm	10
5. Humbjet në Sistemin elektro-energjetik	11
6. Importi dhe eksporti i energjisë elektrike	12
7. Mundësitë e ndryshimit të strukturës tarifore	14
7.1 Tarifa sezonale	14
7.2 Tarifa ditore: tarifa e lartë (TL) dhe tarifa e ulët (TU)	16
7.3 Blllok tarifa	18
8. Përmbledhje e analizave të strukturës tarifore	20
8.1. Tarifa sezonale (sezona e lartë dhe sezona e ulët)	20
8.2. Tarifa ditore (e lartë dhe e ulët).....	21
8.3. Blllok Tarifat	22
9. Ndikimet e thjeshtësimit të strukturës tarifore.....	23
SHTOJCA 1: Tarifat ekzistuese me pakicë për konsumatorët e rregulluar.....	26

PASQYRA

Bazuar në nenin 41 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe në aktet nënligjore (Rregulla për Përcaktimin e Çmimeve), Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) është përgjegjëse për përcaktimin e të hyrave të lejuara për të licencuarit dhe përcaktimin e tarifave për aktivitetet e rregulluara në sektorin e energjisë në Republikën e Kosovës. Struktura e tanishme tarifore ka qenë e aprovuar nga Bordi i ZRRE gjatë shqyrtimit tarifor në Mars të vitit 2007. Kjo strukturë tarifore nga muaji Shtator 2013 është objekt i vlerësimit nga ZRRE. Gjatë kësaj periudhe ZRRE me kujdes ka vlerësuar strukturën ekzistuese tarifore dhe modifikimet e saj të mundshme të cilët do të pasqyrojnë nevojat e konsumatorëve, ndërmarrjeve energjetike dhe sistemit energjetik të Kosovës. Gjatë këtij procesi, ZRRE ka pasur asistencë nga konsulentët Advanced Engineering Associates International Inc (AEAI), projekt i financuar nga USAID-i.

Në përcaktimin e tarifave, ZRRE-ja ndjek parimet e rregullimit, i cili përveç rregullimit “ekonomik” fokusohet në çmime, kualitetin e shërbimit, sigurinë e furnizimit si dhe në investime. Ajo po ashtu merr parasysh edhe aspektin social, mjedisin, shëndetin, si dhe përbalueshmërinë e çmimeve nga ana e konsumatorëve.

Pas analizave të kujdesshme të strukturës tarifore, Bordi i ZRRE-së ka ardhur në përfundim se hapja e konsultimit publik që mund të rezultojë në ndryshime të strukturës tarifore është e dobishme për konsumatorët shtëpiak dhe sistemin në përgjithësi. Struktura e tanishme tarifore në përgjithësi është vlerësuar si e komplikuar dhe vështirë të kuptohet nga konsumatorët. Qëllimi i strukturës së tanishme tarifore është të paraqes profilin e ngarkesës për konsumatorët, të reflektoj koston e shërbimit, si dhe çmimet të jenë të përbalueshme për konsumatorët. Duhet të theksohet se struktura tarifore nuk ndikon te ndërmarrjet e licencuara sepse pavarësisht strukturës tarifore, të hyrat e lejuara të përgjithshme për furnizimin e konsumatorëve të rregulluar përcaktohen në bazë të kostove reale të këtyre ndërmarrjeve.

Ndryshimi i strukturës tarifore ka ndikim të theksuar në ndryshimin e tarifave të rregulluara të konsumatorëve, të cilat aplikohen për të gjithë konsumatorët shtëpiak në Republikën e Kosovës. Një ndryshim i strukturës së tanishme tarifore për konsumatorët shtëpiak mund të ketë pasoja negative në nivelin e përbalueshmërisë së çmimit të energjisë elektrike bazuar në kategorinë e konsumit dhe nivelin të përdorimit të energjisë elektrike. Struktura e tanishme tarifore për shkak të kufizimeve të sistemit tonë energjetik favorizon konsumatorët shtëpiak të cilët konsumojnë më pak energji elektrike, pjesë e të cilëve është një përqindje e madhe e konsumatorëve në Kosovë. ZRRE pajtohet që tarifat duhet të jenë më të thjeshta dhe të kuptueshme për konsumatorët, por jo që për hir të thjeshtësisë të dëmtohen konsumatorët.

Duke pasur parasysh këto elemente, dhe për informim të palëve të interesuara, në këtë dokument ZRRE ka vlerësuar elemente të cilët në mënyrë direkte ndikojnë në strukturë tarifore, siç është: niveli i zhvillimit të sektorit enegjetik të Kosovës, parimet e strukturës tarifore, format e ngarkesës, humbjet në sistem, importet dhe eksportet e energjisë elektrike dhe niveli i tarifave ekzistuese.

Për të mundësuar konsultime sa më të hapura, ZRRE ka hartuar këtë dokument, ku janë paraqitur avantazhet dhe disavantazhet e disa opsioneve të strukturës tarifore. Gjithashtu janë paraqitur ndikimet e mundshme të strukturës tarifore në sistem dhe te tarifat e rregulluara për konsumatorë. Gjatë hartimit të opsioneve të mundshme në këtë dokument ZRRE-ja ka marrë parasysh komentet nga palët e interesuara, të cilat i janë drejtuar ZRRE-së përmes kërkesave zyrtare, dhe i ka kushtuar vëmendje të posaçme rekomandimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

1. STRUKTURA TARIFORE DHE TARIFAT EKZISTUESE

Parimet kryesore lidhur me dizajnimin e strukturës tarifore me pakicë në sektorin e energjisë elektrike janë se tarifat duhet të jenë të arsyeshme, transparente, të kuptueshme, të pasqyrojnë kostot dhe të nxisin konsum eficient. Gjatë dizajnit të strukturës tarifore të konsumatorëve shtëpiak inkurajohet një balancë ndërmjet thjeshtësisë, kompleksitetit dhe drejtësisë.

Është e drejtë universale e të gjithë konsumatorëve për furnizim me energji elektrike. Për sigurimin e kësaj energjie duhet të kryhen aktivitetet e prodhimit, transmissioinit, shpërndarjes etj. Në mungesë të kapaciteteve prodhuese në Kosovë kostot marginale të furnizimit janë dukshëm më të larta në kohën e ngarkesës maksimale - pikut, e cila rëndohet edhe më tej me çmime shumë të larta të importit.

ZRRE gjatë zhvillimit të strukturës së tanishme tarifore ka marrë parasysh nivelin e varfërisë dhe standardin e jetesës në Kosovë, si dhe i ka kushtuar vëmendje të veçantë mbrojtjes së konsumatorëve në nevojë.

Një shembull tipik i cili tregon pjesëmarrjen e kostove të energjisë elektrike sipas të licencuarve për konsumatorët fundor është prezantuar në figurën në vijim.




Fig. 1 Pjesëmarrja e kostove sipas të licencuarve në vitin 2012

Në përputhje me rregullat dhe metodologjitë përkatëse të aprovuara nga ZRRE, tarifat e energjisë elektrike janë të bazuara në parimin e kostos reale të shërbimit për secilin grup të konsumatorëve në nivele të ndryshme të tensionit. Kostot e përfshira në tarifat e rregulluara duhet të ndahen ndërmjet kategorive të konsumatorëve, brenda secilit grup të konsumatorëve, ndërkohë që ngarkesa bazë për çdo kosto duhet të përcaktohet. Komponentët kryesorë të tarifave dhe ngarkesave të aplikueshme në Kosovë, janë si më poshtë:

- Ngarkesa për energji elektrike (aktive dhe reaktive) e cila zbatohet për energjinë e konsumuar (të matur) për secilin grup të konsumatorëve.
- Ngarkesa për fuqinë e angazhuar e cila zbatohet për kërkesën maksimale të matur (kW) për secilin konsumator në çdo kohë të ngarkesës.
- Ngarkesa për kapacitet e cila zbatohet për kapacitetin e kyçur dhe të kontraktuar (në kW ose kVA) për grupin e konsumatorëve për të cilët zbatohet kapaciteti.

- Ngarkesa e konsumatorit (e njohur edhe si ngarkesa fikse) zbatohet me një normë fikse për çdo konsumator në çdo kohë të ngarkesës.

Në strukturën e tanishme tarifore blloku i parë i konsumit të energjisë elektrike ka një çmim më të ulët sesa çmimi mesatar i energjisë elektrike, dhe iu mundëson të gjithë konsumatorëve shtëpiak që të përballojnë nevojat e domosdoshme të konsumit. Konsumi në bllokun e dytë është i përafërt me koston e shërbimit, ndërsa konsumi në bllokun e tretë (mbi 600 kWh) ka çmim më të lartë, në mënyrë që të subvencionojë blloqet tjera.

Struktura tarifore ekzistuese me blloqe ka për qëllim të ngarkojë konsumatorët shtëpiak me çmime më të ulëta për konsum më të ulët të energjisë elektrike, dhe ngarkon me çmime më të larta konsumatorët shtëpiak me konsum më të lartë. Në këtë mënyrë, konsumatorët më të ardhura të ulëta përfitojnë nga çmimet më të lira të konsumit të energjisë elektrike. Kjo bazohet mbi premisën e pranuar përgjithësisht që konsumatorët të cilët kanë të ardhura më të ulëta konsumojnë më pak energji elektrike, ndërsa ata që janë në një situatë të mirë financiare konsumojnë më shumë.

Sipas të dhënave për vitin 2013, 75% e konsumatorëve nga numri i gjithmbarshëm kanë shpenzim më të ulët se 600 kWh.

Tarifat e ndara në blloqe përcaktohen në formën:

- niveli prej 0 deri 200 kWh, që vlen për të gjithë konsumatorët,
- niveli prej 200 kWh deri 600 kWh, dhe
- niveli mbi 600 kWh.




Fig. 2. Numri i konsumatorëve sipas harximit të energjisë elektrike

Struktura tarifore ekzistuese e konsumatorëve shtëpiak në Kosovë është e tillë që përveç që është dizajnuar në tri blloqe, ajo gjithashtu ka çmime të ndryshme për sezonin e dimrit dhe të verës, dhe për konsumin gjatë ditës dhe natës, në mënyrë që të reflektoj kostot e ndryshme të energjisë elektrike në kohë të ndryshme. Tarifat gjatë kohës së ditës – natës (tarifa e lartë dhe e ulët) dhe tarifat sezonale (sezona e lartë dhe sezona e ulët) shfrytëzohen për të nxitur konsum më të ulët të energjisë elektrike, sidomos në kohët e ngarkesës maksimale të pikut. Tarifat ditore dhe sezonale janë të lejuara edhe sipas Nenit 42, paragrafi 3.11 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, ku parashihet se “lejohen tarifat sezonale dhe tarifat sipas kohës së shfrytëzimit” .

Tarifa/ Sezoni	Dimër	Verë
Lartë	07:00 - 22:00	08:00 - 23:00
Ulët	22:00 - 07:00	23:00 - 08:00

Tab. 1. Periudhat e tarifave të energjisë elektrike

Në shtojcën nr. 1 janë paraqitur të gjitha tarifat me pakicë për konsumatorët e rregulluar.

2. KONSUMI SEZONAL

Ngarkesa në sistemin elektroenergjetik të Kosovës ndryshon gjatë vitit, ku në sezonën e lartë është shumë më e lartë se sa në sezonën e ulët.

Tabela nr.2 tregon format e ngarkesës për ditët e dimrit dhe verës në vitin 2012. Këto mbulojnë ditët në vijim:

- Piku gjatë ditëve të javës në dimër - 31 janar 2012
- Piku gjatë fundjavës në dimër - 15 janar 2012
- Piku gjatë ditëve të javës në verë - 15 prill 2012
- Piku gjatë fundjavës në verë - 10 prill 2012

Këto të dhëna janë të bazuara në prodhimin nga njësitë prodhuese në Kosovës si dhe nga importi. Nuk është bërë asnjë përshtatje për ngarkesën e pafurnizuar.

		Ora												
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
DIMRI	dita e javës gjatë dimrit	717	642	667	669	656	682	751	816	834	938	918	951	960
	fundjava gjatë dimrit	833	746	700	676	655	660	694	757	851	931	957	959	967
VERA	dita e javës gjatë verës	641	560	512	493	482	501	546	650	767	834	759	648	656
	fundjava gjatë verës	542	472	425	403	390	402	444	531	594	677	716	743	743
		Ora												
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
DIMRI	dita e javës gjatë dimrit	61.5	55.1	57.3	57.4	56.3	58.5	64.5	70.0	71.6	80.5	78.8	81.6	82.4
	fundjava gjatë dimrit	75.5	67.6	63.4	61.2	59.3	59.8	62.9	68.6	77.1	84.3	86.7	86.9	87.6
VERA	dita e javës gjatë verës	68.9	60.2	55.0	53.0	51.8	53.8	58.6	69.8	82.4	89.6	81.5	69.6	70.5
	fundjava gjatë verës	59.1	51.5	46.3	43.9	42.5	43.8	48.4	57.9	64.8	73.8	78.1	81.0	81.0
		Ora												
		13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	total
DIMRI	dita e javës gjatë dimrit	960	952	953	967	1018	1132	1159	1165	1144	1130	1099	1001	21921
	fundjava gjatë dimrit	967	944	923	942	1007	1088	1099	1101	1104	1094	1045	967	21700
VERA	dita e javës gjatë verës	656	780	752	733	716	704	740	860	931	923	873	772	16833
	fundjava gjatë verës	743	747	734	750	762	769	778	840	896	917	863	759	15897
		Ora												
		13.00	14.00	15.00	16.00	17.00	18.00	19.00	20.00	21.00	22.00	23.00	24.00	Mes.
DIMRI	dita e javës gjatë dimrit	82.40	81.72	81.80	83.00	87.38	97.17	99.48	100.00	98.20	97.00	94.33	85.92	78.40
	fundjava gjatë dimrit	87.59	85.51	83.61	85.33	91.21	98.55	99.55	99.73	100.00	99.09	94.66	87.59	82.12
VERA	dita e javës gjatë verës	70.46	83.78	80.77	78.73	76.91	75.62	79.48	92.37	100.00	99.14	93.77	82.92	81.56
	fundjava gjatë verës	81.03	81.46	80.04	81.79	83.10	83.86	84.84	91.60	97.71	100.00	94.11	82.77	78.85

Tab. 2. Piku për orë dhe gjatë sezonës

Konsumi më i lartë deri më tani në sistemin elektro-energjetik të Kosovës, 1165 MWh/h, është regjistruar më 31 dhjetor 2012.




Fig. 3. Ngarkesa gjatë sezonës dimërore

Nga grafiku për sezonën e dimrit (fig.3) mund të vërehet se ekzistojnë tri periudha mjaft të dallueshme gjatë ditës. Këto periudha mbulojnë orët prej 00:00h deri në 07:00h; 07:00h deri në 17:00h dhe 17:00h deri në 24:00h. Grafiku tregon se ekzistojnë mundësi për rrafshimin e lakorës duke zhvendosur ngarkesën nga periudha e tretë në atë të parën apo të dytën.




Fig. 4. Ngarkesa mesatare për orë gjatë sezonës së lartë

Figura nr. 4 paraqet ngarkesën mesatare për orë gjatë sezonës së lartë për dallim nga figura nr. 3 që paraqet ngarkesën për një ditë të caktuar (piku gjatë ditëve të javës në dimër - 31 janar 2012 dhe piku gjatë fundjavës në dimër - 15 janar 2012).




Fig. 5. Ngarkesa gjatë sezonës verore

Figura për sezonën e ulët (fig. 5) ka formë të ngjashme me grafikun e e lartë për fundjavën gjatë verës edhe pse në një nivel më të ulët, ku pikun arrin rreth 900 MW në verë dhe rreth 1100 MW në dimër. Nga figura për sezonën e ulët mund të vërehet se ka përsëri tri periudha mjaft të dallueshme të konsumit gjatë ditës. Këto mbulojnë orët nga 00:00h deri në 08:00h; 08:00h deri në 17:00h dhe nga 17:00h deri në 24:00h. Këto periudha zhvendosen për shkak të orëve më të gjata të ditës dhe ngarkesës së ulur për ngrohje.




Fig. 6. Ngarkesa mesatare për orë gjatë sezonës së ulët

Figura nr. 6 paraqet ngarkesën mesatare për orë gjatë sezonës së ulët për dallim nga figura nr. 5 që paraqet ngarkesën për një ditë të caktuar (piku gjatë ditëve të javës në verë – 15 prill 2012 dhe piku gjatë fundjavës në verë – 10 prill 2012).

Diagramet e ngarkesës mund të përdoren për të përcaktuar përqindjen e energjisë së konsumuar në periudhën e pikut dhe jashtë pikut. Duke i kombinuar diagramet e ngarkesës së pesë ditëve të javës dhe dy ditëve të fundjavës mund të fitojmë një vlerësim mjaft të mirë se si ndahet energjia e pikut dhe jashtë pikut duke mbledhur ngarkesat më të larta për orët e pikut.

Bazuar në format e mësipërme të ngarkesës dhe duke i përdorur këto të dhëna për të përfaqësuar javët tipike, përqindja e konsumit gjatë pikut dhe jashtë pikut ndahet si në vijim.

Dimër: Piku 71.7% Jashtë pikut 28.3%

Verë: Piku 71.5% Jashtë pikut 28.5%

3. KONSUMI DITOR

Përveç ndryshimeve të konsumit sezonal në sistemin elektroenergetik ka ndryshime të konsumit edhe gjatë ditës (gjatë 24 orëve). Analiza e diagramit të konsumit ditor është gjithashtu e rëndësishme, dhe prezantohet me zbërthimin e orëve gjatë ditës. Në mënyrë që të krijohet një pasqyrë e qartë për dallimet e konsumit ditor gjatë tërë vitit, në figurën më poshtë (fig.7) është paraqitur një diagram kumulativ vjetor për çdo orë. Përveç konsumit, diagrami paraqet edhe prodhimin për orë, shkëmbimin për orë dhe ndërprerjet (reduktimet) për orë.

Diagrami i konsumit ditor në Kosovë në figurën më poshtë (fig. 5) paraqet mesataren e konsumit për çdo orë për tërë vitin. Nga diagrami shihet qartë se ndryshimi kryesor është në mes orëve të ditës dhe atyre të natës, që shpesh tejkalon proporcionin 1 me 2. Edhe mesatarja vjetore e maksimumit të konsumit sipas orëve paraqet një ndryshim tepër të madh: minimumi i mesatares (orë për orë) është 432 MW në ora 05:00h, dhe maksimumi i mesatares (orë për orë) është 780 MW në ora 21:00h.




Fig. 7. Diagrami ditor (mesatarja e orëve) - 2012

Ndryshimi i nivelit të konsumit gjatë orëve të ditës dhe natës paraqet sfida të vështirë për ndërmarrjet e licencuara në sektorin e energjisë elektrike, duke ditur se prodhimi i energjisë elektrike është kryesisht i bazuar në gjeneratorët që operojnë me linjit dhe që këta gjenerator janë të vjetruar dhe jo fleksibil. Nga diagrami (fig.7) shihet se që nga ora 08:00h deri në orën 23:00h, në mesatare ka pasur mungesë të energjisë elektrike nga prodhimi vendor dhe kjo është plotësuar me import apo është reduktuar konsumi, ndërsa nga ora 00:00h deri në ora 07:00h ka pasur teprica dhe është eksportuar energji elektrike.




Fig. 8. Diagrami ditor (mesatarja e oreve) per vitin 2012

Diagrami i mësipërm (fig.8) paraqet ndryshimin e lakores në sezonin e lartë dhe sezonin e ulët. Nga diagrami vërejmë se lakoret kanë formë afërsisht të ngjashme, por me dallime të vogla ku gjatë dimrit piku më i lartë është nga ora 17:00h deri në orën 23:00h, ndërsa në verë prej orës 20:00h deri në orën 23:00h. Është me rëndësi të veçantë të ceket se vlerat e konsumit për periudhën nga ora 10:00h deri 23:00h, sidomos gjatë sezonit të ulët ndryshojnë fare pak. Derisa ndryshimi i maksimumit ditor ndaj minimumit gjatë natës është 269 MW, që paraqet nivelin maksimal të prodhimit të njësisë më të madhe në vend. Maksimumi në ora 10:00h dhe maksimumi i përgjithshëm ditor në ora 21:00h dallon vetëm për 31 MW. Në bazë të kësaj mund të konsiderojmë se e tërë kjo periudhë është mjaft e ngjashme, me konsum të lartë dhe praktikisht i takon tarifës së lartë.

Bazuar në kërkesat e konsumit për energji elektrike, në një pjesë të konsiderueshme të vitit, brenda të njëjtës ditë paraqiten mungesa të theksuara të energjisë, që duhet të mbulohen nga importi (me çmime të larta), ndërsa gjatë natës paraqiten teprica që duhet të eksportohen (me çmime të ulëta). Natyrisht që orët e mbrëmjes janë me konsum më të lartë por efektin kryesor që ka ndikim në kosto (problemin mungesë – tepricë) e paraqet ndryshimi i periudhës ditë natë, ashtu siç janë vendosur edhe tarifatat ekzistuese.




Fig. 9. Mesatarja mujore e maksimumeve dhe minimumeve ditore për vitin 2012

Diferenca mes mesatares së maksimumeve dhe minimumeve ditore të konsumit gjatë vitit 2012 është dhënë në figurën nr.9, ku shihet qartë se ka një dallim të madh midis minimumeve dhe maksimumeve të konsumit. Dallimet e tilla paraqesin pengesë serioze për ndjekjen e diagramit të konsumit dhe për të ruajtur devijimet brenda sistemit në kuadër të kufijve të lejuar, sidomos kur merret parasysh jofleksibiliteti i njësive gjeneruese nga linjiti.

4. PJESËMARRJA E KATEGORIVE NË KONSUM TË PËRGJITHSHËM

Pjesëmarrja e konsumit të amvisërisë është ende dominuese ndaj konsumit të përgjithshëm të faturuar dhe përbënë 59.5% në vitin 2013, ndërsa në vitin 2012 ishte 57.74 %. Në figurën nr. 10 janë paraqitur në përqindje kategoritë e konsumit në raport me konsumin e faturuar.




Fig. 10. Pjesëmarrja e kategorive të konsumatorëve për vitin 2013




Fig. 11. Pjesëmarrja e kategorive në konsumin bruto dhe neto për vitin 2012

Zhvillimi i sektorit të energjisë përbën bazën për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik. Ekziston nevoja për ristrukturim dhe investime si në prodhimin e energjisë elektrike, po ashtu edhe në transmission dhe shpërndarje. Konsumi i energjisë elektrike në nivelin e shpërndarjes në vitin 2013 ka qenë 4,790 GWh, ndërsa në vitin 2012 ka qenë 4,768 GWh, me një rritje prej 0.4%.

5. HUMBJET NË SISTEMIN ELEKTRO-ENERGJETIK

Humbjet në sistemin elektro-energjetik përbëhen nga humbjet në transmision dhe në shpërndarje, të cilat ndahen në humbje teknike dhe komerciale. Humbjet kanë një rëndësi të posaçme dhe ZRRE i përcjell me kujdes të veçantë. Niveli i lartë i humbjeve, veçanarisht në sezonën e lartë krijon vështirësi të mëdha në furnizimin e konsumatorëve në kohët e ngarkesave maksimale.

Vitet	Konsumi i	Humbjet ne	
	pergjithshem	MWh	%
2008	4,943,714	214,814	4.35
2009	5,275,108	174,573	3.31
2010	5,505,716	131,043	2.38
2011	5,584,370	115,315	2.06
2012	5,467,139	109,028	1.99
2013	5,520,075	110,336	2.00

Tab. 3: Konsumi dhe humbjet në transmision 2008-2012

Gjatë viteve të fundit në saje të investimeve të bëra në rrjetin e transmisionit ka pasur zvogëlim të ndjeshëm të humbjeve. Ky zvogëlim pothuajse ka arritur nivelin e pranueshëm dhe është në nivel të përafërt me vendet e rajonit. Siç shihet në tab. 3, trendi i humbjeve të energjisë elektrike në transmisionka vazhduar të mbetet pothuajse i njëjtë edhe në vitin 2013, krahasuar me vitin 2012, kur humbjet kanë qenë 110 GWh, ose në përqindje 2.00% kundrejt konsumit të përgjithshëm, përdërisa në vitin 2012 këto humbje kanë qenë 109 GWh apo 1.99%.




Fig. 12. Humbjet në nivel të shpërndarjes për vitet 2006 - 2013

Përkundër uljes së vazhdueshme të humbjeve në sistemin e shpërndarjes, humbjet e përgjithshme të energjisë elektrike në shpërndarje mbeten mjaft të larta. Humbjet e përgjithshme në shpërndarje në vitin 2013 kanë qenë 1,701 GWh apo 35.52% kundrejt energjisë elektrike të furnizuar në shpërndarje, përdërisa në vitin 2012 humbjet kanë qenë 1,750 GWh apo 36.69%. Humbjet e përgjithshme në shpërndarje përbëhen nga humbjet teknike, të cilat janë të larta për shkak të rrjetit të vjetruar dhe mungesës së investimeve, dhe në humbjet komerciale, të cilat janë humbjet në rrjet që shkaktohen nga veprimet e paligjëshme në sistemin e shpërndarjes (vjedhje dhe keqpërdorime të njehsorëve). Në fig. 12 janë të paraqitura të dhënat për nivelin e humbjeve të përgjithshme në shpërndarje për tetë vitet e fundit.

Duke ju referuar të dhënave të figurës nr. 10 vihet re se nga viti 2006 e deri më sot, ka një tendencë pozitive të rënies së vazhdueshme, por me vlerë të ulët të zvogëlimit të humbjeve në sistemin e

shpërndarjes. Lakorja e zvogëlimit të humbjeve komerciale është më e theksuar por jo e mjaftueshme, ndërsa për humbjet teknike rënia është e një niveli më të ulët për shkak të sistemit të vjetruar të shpërndarjes dhe mungesës së investimeve në përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes.

Sasia e humbjeve komerciale është rreth 972,769 MWh për vitin 2013, e cila është tepër e lartë për një sistem të shpërndarjes me kërkesë totale të energjisë prej 4.7 TWh në vit. Zvogëlimi i humbjeve komerciale, jo vetëm që do të ndikonte pozitivisht në tarifën e energjisë elektrike, por do të rriste edhe efikasitetin e shfrytëzimit të energjisë elektrike nga konsumatorët, duke ndikuar në rritjen e sigurisë së furnizimit. Niveli i lartë i humbjeve në shpërndarje vazhdon të ngarkojë sistemin energjetik, ndërsa zvogëlimi i tyre nuk kërkon investime si në rastet e humbjeve teknike. Me vetëdijësimin më të lartë të qytetarëve dhe një angazhim të plotë nga ndërmarrjet e licencuara duke u mbështetur maksimalisht nga organet shtetërore (në veçanti nga gjyqësia dhe policia), rezultatet për zvogëlimin e humbjeve komerciale do të ishin më të larta.

6. IMPORTI DHE EKSPORTI I ENERGJISË ELEKTRIKE

Për dallim nga vitet paraprake në vitin 2013 Kosova ka qenë neto eksportuese e energjisë elektrike, megjithatë në kohën e pikut kanë dominuar importet. Furnizuesi publik (FP) ka importuar përmes kontratave komerciale të lidhura me importues të energjisë elektrike dhe ka shkëmbyer energji elektrike me sistemet e shteteve rajonale, duke mundur mbulimin e nevojave të konsumatorëve.




Fig. 13 Importi i energjisë elektrike dhe çmimi në vitin 2013

Edhe pse rezulton se gjatë vitit 2013 Kosova ka qenë neto eksportuese e energjisë elektrike, në bazë të sasisë së energjisë elektrike (*kilovatorë*), duhet të theksohet se për shkak të importit të lartë gjatë pikut, totali i importit në vlerë monetare ka qenë më i lartë se totali i eksporteve në vlerë monetare (eksporti=21.34 milion € dhe importi=28.45 milion €).

Energjia elektrike e importuar me kontrata komerciale importi (tender) gjatë vitit 2013 ka qenë 457,815 MWh me vlerë prej 28,447,948 €, me çmim mesatar prej 62.14 €/MWh, ndërsa energjia elektrike e importuar në vitin 2012 ka qenë 571,897 MWh, me çmim mesatar 79.46 €/MWh. Sasia e energjisë elektrike e importuar është për 20 % më e ulët se në vitin e kaluar, përderisa çmimi mesatar është për 22 % më i ulët krahasuar me vitin 2012.




Fig. 14. Eksporti me kontrata dhe shkëmbimi për vitin 2013

Gjatë vitit 2013 eksporti ka qenë shumë i lart krahasuar me vitet e kaluara, pra ka pasur teprica të energjisë. Këto teprica janë regjistruar kryesisht në orët e natës (tarifa e ultë), kur në sistemet rajonale oferta për energji gjatë natës rritet në sasi të mëdha dhe kjo ka ndikuar që çmimet e eksportit të jenë dukshëm më të ulëta se sa çmimet e importit.

Energjia elektrike e eksportuar me kontrata komerciale gjatë vitit 2013 ka qenë 755,504 MWh me vlerë prej 21,341,724 €, me çmim mesatar prej 28.2 €/MWh, ndërsa energjia elektrike e eksportuar në vitin 2012 ka qenë 371,316 MWh, me çmim mesatar 31.16 €/MWh. Sasia e energjisë elektrike e eksportuar është për 103 % më e lart se në vitin e kaluar, përderisa çmimi mesatar është për 9 % më i ulët krahasuar me vitin 2012.

Për dallim nga importi, eksporti në vitin 2013 është realizuar në çdo muaj të vitit, përveç muajit janar. Kjo ka ndodhur për faktin se remontet kapitale të planifikuara për vitin 2013 për njësitë gjeneruese nuk janë realizuar.

7. MUNDËSITË E NDRYSHIMIT TË STRUKTURËS TARIFORE

ZRRE, në pajtim me Nenin 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë bënë konsultime për çështjet që kanë të bëjnë me tarifat. Lidhur me strukturën e tanishme tarifore në Kosovë, Bordi i ZRRE-së ka pranuar komente dhe reagime të shumta nga palët e treta, ku sipas komenteve, struktura tarifore në përgjithësi është vlerësuar si e komplikuar dhe vështirë të kuptohet nga konsumatorët.

Qëllimi i strukturës së tanishme tarifore ka qenë që të paraqes profilin e ngarkesës për konsumatorët, të reflektoj koston e shërbimit, si dhe çmimet të jenë të përballueshme për konsumatorët. ZRRE i sheh të arsyeshme komentet e palëve të treta për thjeshtësimin e strukturës tarifore, mirëpo duhet pasur kujdes që thjeshtësimi i saj të mos rezultoj në dëmtimin e konsumatorëve. Me qëllim të informimit të publikut dhe palëve të interesit, më poshtë janë dhënë disa opsione të mundshme për strukturën tarifore. Tarifat duhet të sigurojnë sinjale të duhura sa i përket sjelljes së konsumatorit, siç janë kursimi dhe zhvendosja e pikut.

Opsionet e mundshme të ndryshimit të strukturës tarifore dhe arsyetimet e tyre janë të paraqitura në tre shtylla kryesore:

- tarifa sezonale (tarifat e sezonës së lartë dhe sezonës së ulët);
- tarifa ditore (tarifat e lartë dhe tarifa e ulët); dhe
- tarifa në blloqe.

7.1 Tarifa sezonale

Tarifat sezonale janë të ndara në dy sezona (të njohura si sezona dimër-verë):

- sezona e lartë (sezona dimër) fillon nga periudha 1 tetor – 31 mars; dhe
- sezona e ulët (sezona verë) fillon nga periudha 1 prill – 30 shtator.

Emërtimi i sezonave dimër-verë është bërë vetëm për të bërë dallim më të lehtë në mes të sezonës së lartë dhe të ulët të konsumit të energjisë elektrike, dhe nuk ndërlidhet me fillimin apo me mbarimin e stinëve.

Me fillimin e sezonës së lartë konsumi fillon të rritet dhe në të njëjtën kohë çmimet janë më të larta (pasi që tarifat e sezonës së lartë janë më të larta sesa tarifat e sezonës së ulët), që paraqet një kosto shtesë për buxhetin familjar të konsumatorëve shtëpiak dhe mundësinë e tyre për të kryer pagesën për energji elektrike. Konsumatorët në sezonën e ulët paguajnë nën kosto mesatare, ndërsa e kundërta ndodh për sezonën e lartë. Tarifa sezonale është vendosur për ta nxitur kursimin e energjisë elektrike gjatë muajve kur ngarkesa rritet, sepse me rritjen e ngarkesës zvogëlohen edhe mundësitë për të furnizuar të gjithë konsumatorët.

1. Më poshtë janë paraqitur disa avantazhe dhe disavantazhe për mbajtjen e tarifës sezonale:

	Avantazhet për mbajtjen e tarifave sezonale	Disavantazhet për mbajtjen e tarifave sezonale
1	Inkurajon konsumatorët për të kursyer energjinë elektrike në kohën e ngarkesave maksimale gjatë sezonës së lartë	Dallim i lartë në mes çmimit të sezonës së lartë dhe të ulët prej 38%, duke shkaktuar vlerë të lartë të faturimit për konsumatorët e amvisërisë në sezonin e lartë (dimëror), kjo poashtu ka rezultuar që konsumatorët në sezonën e verës paguajnë nën koston reale
2	Tarifat sezonale mund të ndikojnë në uljen e importit në kohën e sezonës së lartë	
3	Kostot reflektohen në mënyrë më adekuate për shkak të prodhimit të pamjaftueshëm dhe importeve të mundshme gjatë sezonës së lartë	

2. Më poshtë janë paraqitur disa avantazhe dhe disavantazhet për eliminimin e tarifës sezonale:

	Avantazhet e eliminimit të tarifave sezonale	Disavantazhet e eliminimit të tarifave sezonale
1	Thjeshtohet struktura tarifore dhe kuptohet më lehtë nga konsumatorët	Ekziston mundësia e ndikimit në rritjen e konsumit gjatë sezonës së lartë dhe në rritjen e importit me çmime të larta, kryesisht gjatë kohës së pikut, e cila ndikon drejtpërdrejt në rritjen e çmimit të përgjithshëm të energjisë elektrike
2	Ndihmon në nivelizimin e vlerës së faturave mujore gjatë tërë vitit, duke pasur parasysh se konsumatorët kanë nivel përafërsisht të njëjtë të ardhurave mujore gjatë vitit	Çmimi i njëjtë në të dy sezonat (lartë dhe të ulët) gjatë kohës së dimrit pas eliminimit të tarifës sezonale mund të jetë tërheqës për shfrytëzimin e energjisë elektrike për ngrohje, e cila ndikon edhe në rritjen e ngarkesës
3	Tarifat bëhen më lehtë të administrueshme sepse largohen problemet e vlerave të larta të faturave me ndërrimin e sezonës	
4	Për shkak të alternativave të kufizuara për ngrohje të hapësirave të banimit, disa konsumatorë janë duke e shfrytëzuar energjinë edhe për qëllime të ngrohjes së hapësirave të banimit, pa marr parasysh çmimin e lart në kohën e sezonës së lartë	

7.2 Tarifa ditore: tarifa e lartë (TL) dhe tarifa e ulët (TU)

Struktura ekzistuese tarifore ditore përbëhet nga tarifa e lartë (TL) dhe tarifa e ulët (TU). Koha e shfrytëzimit të tarifës së lartë në sezonën e lartë është nga ora 07:00h deri në ora 22:00h, ndërsa në sezonën e ulët është nga ora 08:00h deri në 23:00h. Me dimenzonimin sa më të mirë të këtyre tarifave ditore (natë dhe ditë) mund të ndikohet pozitivisht në shtyrjen e konsumatorëve për përdorimin sa me eficient të energjisë elektrike në kohën e pikut, posaçërisht në kohën e dimrit.

Në pamundësi të plotësimit të kërkesës në rritje për energji elektrike nga prodhimi vendor, nevojitet të importohet energji, e njëherësh edhe të ngritën kapacitete më të mëdha transmetuese dhe shpërndarëse. Kjo do të ndikonte në rritjen e çmimit të energjisë për njësi. Ndikimin më të madh për rritjen e kërkesës e kanë konsumatorët që kanë shpenzim më të madh, e me këtë ndikojnë në rritjen e çmimit mesatar të energjisë për kilovatorë (kWh).

Më poshtë janë të paraqitura tre opsione të mundshme për tarifën ditore:

1. Tarifat ditore ekzistuese;
2. Modifikimi i tarifës ditore (Tarifa e Lartë të vendoset nga ora 17:00h deri në 23:00h gjatë verës dhe 18:00h deri 24:00h gjatë dimrit);
3. Eliminimi i tarifës ditore dhe zëvendësimi me një tarifë mesatare

1. Tarifat ditore ekzistuese

	Avantazhet e tarifës ditore ekzistuese	Disavantazhet e tarifës ditore ekzistuese
1	Tarifa e lartë e konsumit përputhet me koston e energjisë elektrike. Në periudhën e tarifës së lartë konsumi i energjisë është më i lartë se prodhimi në mesatare vjetore për orë, që imponon edhe import të energjisë elektrike	Mos akordimi i saktë i ndërruesve tarifor në njëhisorët elektrik ndikon në mos pasqyrimin e shpenzimit real sipas tarifave në kohën e shfrytëzimit
2	Duke pasur parasysh jo fleksibilitetin e gjeneratorëve, paraqiten teprica të energjisë nga ora 00:00h deri në ora 08:00h, ndërsa çmimi i eksportit është shumë i ulët	Gjendja momentale e mundësive të shfrytëzimit të energjisë në tarifen e ulët është e vogël te një pjesë e konsumatorëve për shkak të mungesës (reduktimeve) së ujit
3	Mundëson shfrytëzim eficient të energjisë nga konsumatorët gjatë tarifës së ulët duke përfituar çmime më të ulëta, dhe mbron këta konsumatorë	
4	Çmimet në pik janë më të larta dhe çmimet jashtë pikut janë më të ulëta sesa tarifa mesatare, duke paguar kostot në kohën reale që shkaktohen	

2. Modifikimi i tarifës ditore (Tarifa e Lartë të vendoset nga ora 17:00 h deri në 23:00 h gjatë verës dhe 18:00 h deri 24:00h gjatë dimrit)

	Avantazhet e modifikimit të tarifës ditore	Disavantazhe të modifikimit të tarifës ditore
1	Vendosja e TL (nga ora 17:00h-23h:00h dhe 18:00h-24:00h) mund të ndikojë në “hekurosjen” e ngarkesës gjatë ditës (ju mundësohet konsumatorëve që të konsumojnë energjinë elektrike me TU nga ora 24:00h deri në orën 17:00h)	Ndryshimi i kohës tarifore në njehsorët ekzistues (rreth 400,000 njehsor) dhe ndryshimi në programin e faturimit CCP (ang. “Customer Care Package”) merr kohë dhe shkakton kosto shtesë.
2	Mundëson shfrytëzim edhe më eficient të energjisë nga konsumatorët krahasuar me opsionin e parë dhe mundëson zhvendosjen e konsumit në tarifën e ulët edhe për konsumatorët që kanë reduktime të ujit	Me ndryshimin e kohës së tarifave ditore mund të ketë luhatje të çmimit të energjisë varësisht nga struktura e re e përcaktuar ku mund të ketë rritje të tarifës lartë ose tarifës së ulët
3	Çmimet në pik janë më të larta dhe çmimet jashtë pikut janë më të ulëta sesa tarifa mesatare, duke paguar kostot në kohën reale që shkaktohen	

3. Eliminimi i tarifës ditore dhe zëvendësimi me një tarifë mesatare

	Avantazhet e eliminimit të tarifës ditore	Disavantazhe e eliminimit të tarifës ditore
1	Një tarifë mesatare ditore është më e thjeshtë për t’u kuptuar nga konsumatorët	Eliminimi i tarifave ditore do të ndikojë në rritjen e importit të energjisë elektrike, pasi që konsumatorët nuk kanë nxitje për të zvogëluar konsumin në kohën e pikut, e cila rrjedhimisht mund të ndikojë në rritjen e çmimit
2	Më lehtë administrohet nga kompanitë e licencuara	

7.3 Bllok tarifa

Konsumi mesatar i energjisë elektrike në amvisëri është rreth 450 kWh, prandaj duke marr parasysh rritjen e GDP-së gjatë viteve dhe duke pasur parasysh se konsumi është në relacion me GDP mund të konkludohet se konsumi mesatar mund të rritet deri në 500 kWh në vitet e ardhshme.

ZRRE ndjek politikat socialo ekonomike në sektorin e energjisë duke aplikuar strukturën tarifore me tre blloqe për konsumatorët shtëpiak.

Tarifat e ndara në blloqe përcaktohen në formën:

- niveli prej 0 deri 200 kWh që vlen për të gjithë konsumatorët,
- niveli prej 200 kWh deri 600 kWh, dhe
- niveli mbi 600 kWh.

Kjo ndarje është bërë në mënyrë që pagesa për energji elektrike të jetë e përballueshme për konsumatorët shtëpiak me të hyra të ulëta, e të cilët momentalisht përfitojnë nga blloku tarifor me konsum të energjisë nën 200 kWh/muaj, e që nuk shfrytëzojnë energjinë elektrike për ngrohje. Këta konsumatorë shtëpiak ngarkohen me çmim më të ulët se çmimi mesatar i energjisë.

Duke u nisur rekomandimet e komisionit parlamentar, opinionit të gjerë, mediave dhe konsumatorëve, për thjeshtësimin e strukturës tarifore të energjisë elektrike, ku përfshihen edhe blloqet tarifore, më poshtë janë paraqitur tre opsione të mundshme:

1. Bllok tarifa ekzistuese (me tre blloqe)

Struktura e tanishme tarifore me tre blloqe është treguar si mjaft efektive si nga ana e mbrojtjes së konsumatorëve ashtu edhe për reflektimin e kostos. Bllok tarifrat favorizojnë konsumatorët që konsumojnë më pak energji elektrike duke përfshirë edhe ata në nevojë, dhe zvogëlon barrën e subvencioneve nga qeveria për konsumtorët në skemën sociale.

	Avantazhet e bllok tarifës ekzistuese	Disavantazhet e bllok tarifës ekzistuese
1	Çmime janë më të përballueshme për konsum më të ulët, që zakonisht janë konsumatorët me të ardhura më të ulëta	Bllok tarifrat ekzistuese konsiderohen nga konsumatorët si të komplikuar për tu kuptuar
2	Nxit konsum më racional (më të ulët) të energjisë elektrike për të gjithë konsumatorët për shkak të kufizimeve të prodhimit vendor të energjisë elektrike	Tarifrat e larta për konsum më të lartë se 600 kWh, sidomos gjatë tarifës sezonale të lartë
3	Ndikon në zvogëlimin e importit të energjisë elektrike dhe me këtë ndikon në zvogëlimin e çmimit mesatar që do të paguajnë konsumatorët	Ekziston mundësia e gabimit në leximin e njehsorëve të cilët mund të ndikojnë në fatura të energjisë elektrike
4	Rritë sigurinë e furnizimit me energji elektrike	

2. Tarifa me dy blloqe (blloku i I-rë prej 0 - 450 kWh dhe blloku i II-të mbi 450 kWh);

Nga analizat e bëra vërehet shpenzimi mesatar i energjisë për një familje në vitin 2013 ka qenë afro 450 kWh për muaj, prandaj në opsionin e dytë është paraqitur ndarja në dy blloqe duke marrë për bazë këtë mesatare (blloku i I-rë prej 0 - 450 kWh dhe blloku i II-të mbi 450 kWh).

	Avantazhet e tarifës me dy blloqe	Disadvantazhet e tarifës me dy blloqe
1	Paraqet thjeshtësim të strukturës së tanishme të blloqeve tarifore	Është më e komplikuar për të kuptuar krahasuar me tarifën mesatare (pa blloqe), mirëpo më e thjeshtë krahasuar me atë me tre blloqe
2	Nxit konsum më racional (më të ulët) të energjisë elektrike për të gjithë konsumatorët për shkak të kufizimeve të prodhimit vendor të energjisë elektrike	Do të ketë rritje të çmimit të faturës për konsumatorët e bllokut 0 - 200 kWh
3	Ndikon në zvogëlimin e importit të energjisë elektrike dhe me këtë ndikon në zvogëlimin e çmimit mesatar që do të paguajnë konsumatorët deri në 450 kWh	Ekziston mundësia e gabimit në leximin e njehsorëve, të cilët mund të ndikojnë në fatura të energjisë elektrike
4	Mund të ndikoj në sigurinë e furnizimit me energji elektrike	

3. Eliminimi i blloqeve dhe përdorimi i një tarife mesatare

Nëse largohet plotësisht bllok tarifa, kjo do të ishte alternativa më e thjeshtë, megjithatë, nuk jep asnjë nxitje për zvogëlimin e konsumit të përgjithshëm.

	Avantazhet e tarifës mesatare (pa blloqe)	Disavantazhet e tarifës mesatare (pa blloqe)
1.	Struktura tarifore do të jetë më e thjeshtë për tu kuptuar krahasuar me dy opsionet e mësipërme	Mund të ketë rritje të konsumit të energjisë elektrike dhe kjo mund të ndikoj në rritjen e importit të energjisë elektrike
2.	Paraqet koston mesatare të tarifës pavarësisht nivelit të konsumit	Do të ketë rritje të çmimit të faturës për konsumatorët me shpenzim deri 600 kWh
3.	Zvogëlon mundësinë e gabimit në leximin e njehsorëve, të cilët mund të ndikojnë në fatura të energjisë elektrike, rrjedhimisht edhe ankesat e konsumatorëve	Favorizon konsumatorët me shpenzim me të lartë, e të cilët ndikojnë në rritjen e importit të energjisë elektrike dhe me këtë edhe në ngritjen e çmimit mesatar të energjisë elektrike
4.	Më lehtë administrohet nga kompanitë e licencuara	

8. PËRMBLEDHJE E ANALIZAVE TË STRUKTURËS TARIFORE

Sikurse edhe analizat përmbledhja e opsioneve të mundshme janë ndarë në tri pjesë, tarifa sezonale (tarifat e sezonës së lartë dhe sezonës së ulët), tarifa ditore (tarifat e lartë dhe tarifa e ulët) dhe tarifa në blloqe.

8.1. Tarifa sezonale (sezona e lartë dhe sezona e ulët)

Opsioni i parë: Mbajtja e tarifave sezonale ekzistuese

Qëllimi i vendosjes së tarifës sezonale është që të zvogëlohet konsumi gjatë sezonës së lartë, kur ka mungesa të theksuara të energjisë elektrike nga prodhimi vendor për të mundësuar furnizim të rregullt. Po ashtu tarifa sezonale nxitë konsumatorët të mos shfrytëzojnë energjinë elektrike për ngrohje, për shkak të kushteve teknike të sistemit (vjetërsisë së sistemit). Edhe pse tarifa sezonale është duke u aplikuar për një kohë të gjatë, megjithatë sipas të dhënave të viteve të fundit aplikimi i këtyre tarifave nuk ka prodhuar efekt pozitiv në zvogëlimin e konsumit.

Opsioni i dytë: Eliminimi i tarifave sezonale

Eliminimi i tarifës sezonale vlerësohet të jetë më praktike dhe më e përshtatshme si për konsumatorët, ashtu edhe për ndërmarrjet e energjisë. Ky opsion thjeshtëson strukturën tarifore ekzistuese, zvogëlon dallimin e faturave gjatë sezonës së lartë dhe të ulët, shmang ndikimin eventual në lartësinë e pagesave në rast të gabimeve në lexim në kohën e ndërrimit të sezonave, ndërmarrjet do të kenë arkëtim me të njëtrajtshëm gjatë një viti, si dhe më lehtë administrohet.

8.2. Tarifa ditore (e lartë dhe e ulët)

Opsioni i parë: Tarifa ditore ekzistuese

Tarifa ekzistuese ditore përbëhet nga tarifa e lartë (TL) dhe tarifa e ulët (TU). Koha e shfrytëzimit të tarifës së lartë në sezonën e lartë është nga ora 07:00h deri në ora 22:00h, ndërsa në sezonën e ulët nga ora 08:00h deri në 23:00h (ngarkesa e pikut - peak load). Sipas fig.7, grafiku vjetor sipas orëve tregon që konsumi është më i lartë nga ora 08:00h deri 24:00h dhe në këtë periudhë kemi edhe mungesë të energjisë elektrike që mbulohet përmes importit, prandaj edhe kostoja e energjisë duhet të reflektohet në tarifën e lartë dhe të ulët. Kjo ofron një sinjal të mirë për konsumatorët për zhvendosjen e konsumit të energjisë nga tarifa e lartë në tarifën e ulët, kur në Kosovë ka teprica të energjisë gjatë natës dhe çmimi i energjisë është i ulët. Sfidë mbetet implementimi i saktë i tarifës ditore të lartë dhe të ulët për shkak të mos akordimit të saktë të ndërruesve tarifor në njehsorët elektrik, e cila ndikon në pasqyrimin jo real të shpenzimit.

Opsioni i dytë: Modifikimi i tarifës ditore (tarifa e lartë të fillojë nga ora 17:00h deri në 23:00h gjatë sezonës së lartë dhe 18:00h deri 24:00h gjatë sezonës së ulët)

Si opsion i dytë është vlerësuar që koha e shfrytëzimit të tarifës së lartë të zhvendoset dhe të fillojë nga ora 17:00h deri në 23:00h gjatë sezonës së lartë, ndërsa që koha e shfrytëzimit të tarifës së lartë të fillojë nga ora 18:00h deri më 24:00h gjatë sezonës së ulët. Piku më i lartë (periudha e tretë 17:00h – 23:00h) paraqitet gjatë kësaj periudhe që reflektohet edhe me çmimin më të lartë të importit, krahasuar me pjesën tjetër të pikut. Kjo do të ofronte një sinjal modest për konsumatorët për zhvendosjen e këtij piku nga konsumi më i lartë në periudhën e dytë (07:00h – 17:00h). Kjo zhvendosja e konsumit të energjisë do të ndihmojë sepse në periudhën e dytë të pikut sasia e importit është më e ulët. Implementimi i ndryshimit të kohës tarifore në njehsorët ekzistues dhe në programin e faturimit paraqet vështirësi të madhe dhe ndryshimet e tilla marrin kohë dhe shkaktojnë kosto shtesë.

Opsioni i tretë: Eliminimi i tarifës ditore dhe zëvendësimi me një tarifë mesatare

Si opsion i tretë është vlerësuar eliminimi i tarifës ditore (tarifa e lartë dhe e ulët) dhe vendosja e vetëm një tarife ditore (tarifë një vlerëshe) që paraqet një tarifë mesatare mes tarifës së lartë dhe të ulët. Kjo metodë është shumë e thjeshtë për tu kuptuar nga konsumatorët, por nuk nxit kursim të energjisë elektrike në kohën e pikut. Me këtë tarifë ditore mesatare konsumatorët nuk nxiten të shfrytëzojnë energjinë elektrike në bazë të kostove reale të sistemit dhe mund të shkaktojnë shpenzim më të lartë gjatë kohëve të pikut. Aplikimi i këtij opsioni mund të ndikojë në rritjen e importit, në rritje të konsumit që mund shkakton edhe rritjen e çmimit mesatar të energjisë elektrike, si dhe ngarkon sistemin, të cilat mund të shkaktojnë furnizim jo të rregullt të konsumatorëve me energji. Ky opsion thjeshtëson strukturën tarifore ekzistuese, dhe shmang ndikimin eventual në lartësinë e pagesave për shkak të mos akordimit të saktë të ndërruesve tarifor në njehsorët elektrik dhe më lehtë administrohet.

8.3. Bllok Tarifat

Bllok-tarifat përdoren për të nxitur konsum efikas të energjisë elektrike. Njëkohësisht, këto tarifa sigurojnë që interesat në mes të konsumatorëve dhe ndërmarrjeve për energji balancohen në mënyrë adekuate dhe favorizojnë konsumatorët që konsumojnë më pak energji elektrike duke përfshirë edhe ata në nevojë, sipas legjislacionit në fuqi.

Opsioni i parë: Struktura ekzistuese me tre blloqe

Opsioni i parë paraqet strukturën ekzistuese tarifore me tri blloqe për konsumatorët shtëpiak. Aplikimi i strukturës ekzistuese është bërë në mënyrë që pagesa për energji elektrike të jetë më e përballeshme për konsumatorët që konsumojnë më pak energji elektrike, që zankonisht janë familjet me të ardhura më të ulëta. Momentalisht të gjithë konsumatorët përfitojnë nga çmimet e lira të konsumit të energjisë elektrike deri në 200 kWh/muaj. Këto subvencionohen nga kategoria e konsumit mbi 600 kWh/muaj, të cilët ngarkohen me çmime më të larta se çmimi mesatar.

Opsioni i dytë: Tarifa me dy blloqe: Blloku i I-rë prej 0 – 450 kWh dhe Blloku i II-të mbi 450 kWh

Opsioni me dy blloqe tarifore paraqet një ristrukturim të bllok tarifave, thjeshtëson strukturën ekzistuese tarifore krahasuar me opsionin e parë. Ky opsion ka impakt më të vogël në rritjen e çmimit mesatar për shumicën e konsumatorëve krahasuar me eliminimin e bllok tarifave (opsioni i tretë). Ky opsion nxit shfrytëzim më eficient të energjisë elektrike krahasuar me opsionin e tretë, me ndikim në uljen e konsumit për konsumatorët në amvisëri. Meqëse konsumi mesatar i konsumatorëve në amvisëri është deri në 450 kWh, atëherë ky opsion mund të jetë më i arsyeshëm për zbatim krahasuar me opsionin e parë.

Opsioni i tretë: Eliminimi i blloqeve dhe përdorimi i një tarife mesatare

Nëse largohet plotësisht bllok tarifa, ajo do të ishte alternativa më e thjeshtë, megjithatë, nuk siguron sinjal për zvogëlimin e konsumit të energjisë elektrike dhe përdorimit me eficient të saj. Ky opsion ngarkon me çmime më të larta konsumatorët me konsum më të ulët, krahasuar me opsionin me blloqe, ndërsa favorizon konsumatorët me konsum më të lartë, të cilët ndikojnë në rritjen e importit të energjisë elektrike, dhe me këtë edhe në ngritjen e çmimit mesatar të energjisë elektrike. Duhet të theksohet se ankesat më të mëdha të konsumatorëve siç janë paraqitur gjatë muajve të dimrit (gjatë vitit 2012 dhe 2013) vjen nga çmimi më i lartë i tarifës me konsum mbi 600 kWh/muaj. Aplikimi i këtij opsioni do të rezultojë në vlera të faturave më të ulëta për konsum më të lartë (të gjithë konsumatorët që shpenzojnë mbi 600 kWh/muaj) dhe në vlera të faturave më larta për konsum të ulët (të gjithë konsumatorët të cilët shpenzojnë më pak se 600 kWh/muaj). Ky opsion thjeshtëson strukturën tarifore ekzistuese në masë të konsiderueshme dhe shmang ndikimet negative të mos akordimit të saktë të njehsorëve elektrik, si dhe më lehtë administrohet.

9. NDIKIMET E THJESHTËSIMIT TË STRUKTURËS TARIFORE

Struktura e tanishme tarifore është llogaritur në mënyrë që të mbajë çmimet e konsumatorëve shtëpiak sa ma të ulët në mënyrë që të jenë të përballueshme për këta konsumator. Kjo është arritur duke vendosur çmime nën kosto të shërbimit për konsumatorët shtëpiak me konsum të ulët dhe duke i subvencionuar këto çmime, me çmime më të larta për konsum më të madh. Struktura e tanishme tarifore është vendosur për të përcjell ngarkesën e sistemit, që do të thotë se ngarkon konsumatorët më çmime më të larta në rastet kur sistemi energjetik ka ngarkesë me të lartë, ndërsa me çmime më të ulëta në rastet kur sistemi energjetik ka ngarkesë me të ulët. Duke pasur parasysh prodhimin e kufizuar të energjisë elektrike në Kosovë, kostoja për energji rritet dukshëm në kohën e ngarkesës maksimale dhe në kohën kur duhet të importojmë energji elektrike për shkak të konsumit të lartë.

Me ndryshimin e strukturës tarifore, në të shumtën e rasteve te konsumatorët shtëpiak të cilët konsumojnë nën 600 kWh, mesatarja e vlerave të faturave do të jetë me e lartë. Në mungesë të prodhimit të mjaftueshëm të energjisë elektrike paraqitet nevoja që të gjithë konsumatorët të mbulojnë çmimet e larta të importit për të siguruar furnizim të sigurtë për konsumatorët shtëpiak.

Në vijim janë paraqitur disa informata preliminare mbi kostot e sistemit energjetik të cilat mund të përdoren për të arritur një tarifë mesatare për konsumatorët shtëpiak. Ndryshimi i sistemit tarifor do të shpie tek ndryshimi në mënyrën e llogaritjes së tarifës për konsumatorët shtëpiak. Deri më tani, për shkak të sistemit tarifor ekzistues, me të gjitha komponentet e veta, çmimi mesatar për një kWh ka qenë variabil varësisht nga koha e konsumit dhe sasia e konsumit. Më thjeshtë, çmimi i një kWh për konsumatorët shtëpiak deri më tani ka qenë i ndryshëm sepse është kalkuluar duke pasur parasysh sezonën, kohën e ditës dhe sasinë e konsumit në kWh. Duhet të theksohet se për ndryshimin e strukturës tarifore (nga ekzistuesja në atë që është më e thjeshtë) kërkohet të nxirret mesatarja e çmimit për një kWh pavarësisht nga koha (tarifat sezonale dhe ditore) apo sasia (bllok tarifa) e konsumit të konsumatorëve shtëpiak (amvisëri).

ZRRE gjatë shqyrtimit të shtatë tarifor (viti 2013) ka përcaktuar Të Hyrat e Lejuara Maksimale të kompanive të licensuara për periudhën 5 vjeçare. Të hyrat e lejuara për kompanitë e licensuara vendosen në mënyrë që t'i mbulojnë kostot e energjisë elektrike nga gjenerimi, transmissioni, shpërndarja dhe furnizimi deri te konsumatori fundor shtëpiak. Këto kosto përshtaten (agjustohen) në baza vjetore, mirëpo prapë paraqesin një supozim preliminar të kostove të sistemit për vitin 2014. Në bazë të informatave dhe supozimeve të bëra nga ZRRE, në këtë pjesë të dokumentit janë paraqitur kostot e sistemit energjetik në përgjithësi, dhe ndarja e tyre sipas kompanive të licensuar, siç shihet në tab.5. Në bazë të këtyre kostove, është përlogaritur për vlerën mesatare të tarifës së rregulluar për konsumatorët shtëpiak. Vendimet përfundimtare për këto kosto do të mirren në fund të periudhës rregullative, në këtë rast deri në 1 Prill të vitit 2014, pra këto janë vetëm parashikime preliminare që ZRRE ka bërë për të shfaqur ndikimet e mundëshme të ndryshimit të strukturës tarifore.

Pavarësisht nga struktura tarifore, konsumatorët e energjisë elektrike, faturohen në atë mënyrë që të sigurohet mbledhja e të gjitha Të Hyrave të Lejuara për të licensuarit, që do të thotë se pavarësisht nga struktura tarifore, të gjitha kostot e sistemit energjetik duhet të mbulohen. Vendimi për të thjeshtësuar strukturën tarifore e detyron ZRRE-në të ndryshoj formën e llogaritjes së këtyre tarifave dhe sa më e thjeshtë është struktura tarifore aq më shumë do të rritet çmimi mesatar i energjisë elektrike për kilovat për kategori që shpenzojnë deri në 600 kWh/muaj. Kostot e supozuara për prodhimin e energjisë elektrike janë paraqitur si në tabelën më poshtë.

Kostoja e Prodhimit të Energjisë Elektrike	(€/MWh)
TC Kosova A	35.7
TC Kosova B	22.6
HC Ujmani	27.5
Prodhim i kyçur në Shpërndarje	43.8
Importet	70.0


Tab. 5: Kostoja e Prodhimit të Energjisë Elektrike

Nga të dhënat në tabelën e mësipërme mund të shihet se varianti më i lirë për prodhimin e energjisë elektrike është duke u prodhuar nga TC Kosova B, përderisa varianti më i shtrenjtë është importimi i energjisë elektrike.

Përveç kostove të prodhimit, sistemi energjetik ka kosto për transmision, shpërndarje, dhe për furnizim deri te konsumatori fundor. Këto kosto shtohen kostove të prodhimit për të përcaktuar tarifën për konsumatorët e rregulluar, dhe për shkak të çmimeve të ndryshme të prodhimit, tarifa mesatare e sistemit ndryshon nga limiti i ulët, që është kostoja e prodhimit të TC Kosovës B deri te limiti i epërm që është kostoja e importeve të energjisë elektrike.

Në tabelën nr.6 janë paraqitur vlerat në euro si ilustrim i kostove të gjithë sistemit energjetik. Duhet të theksohet se këto vlera janë vetëm të supozuara dhe mund të ndryshojnë, mirëpo paraqesin indikacione preliminare për kostot të cilat përbejnë koston e përgjithshme të furnizimit të konsumatorëve shtëpiak të rregulluar në nivelin 0.4 kV për vitin 2014.

Kostot e supozuara të sistemit energjetik për vitin 2014	
	€/milion
Prodhimi Vendor	155.2
Importet	41.9
KOSTT (Trasmisioni)	14.4
OSSH (Distribucioni/Shpërndarja)	31.2
Furnizimi (FPEE)	26.1
Eksportet	(13.7)
TOTALI	255.1



Tab. 6: Kostot e supozuara të sistemit energjetik

Kostot e prodhimit, importeve dhe transmisionit përbëjnë 77.8% të të gjitha kostove të sistemit energjetik, përderisa shpërndarja dhe furnizimi përbëjnë 22.2% të kostove. Në bazë të këtyre të dhënave dhe të kostove të përgjithshme, mund të llogaritet minimumi dhe maksimumi i kostove për të furnizuar një kWh te konsumatorët shtëpiak, që janë të kyçur në nivelin e tensionit 0.4 kV.

Si ilustrim për mënyrën e përcaktimit të tarifës mesatare për konsumatorët shtëpiak janë bërë llogaritje mbi vlerat e mundshme të tarifës mesatare nëse largojmë ndryshimet e vlerës së tarifës sipas konsumit apo kohës së shfrytëzimit. Për të llogaritur tarifën mestare të konsumatorëve shtëpiak përmes kostove të mësipërme dhe të dhënave tjera, tarifa më e ulët e mundëshme për

prodhimin vjen nga TC Kosova B e cila është 2.26 c/kWh, dhe më e larta nga importi prej 7.0 c/kWh. Duke pasur parasysh kostot e prodhimit, për të furnizuar konsumatorët, këtyre kostove duhet t'i alokohen në bazë të përcaktuesve të faturimit të grupeve të ndryshme të konsumatorëve edhe kostot e shpërndarjes dhe furnizimit, të cilat mund të arrijnë vlerën deri në 1.35 c/kWh. Nëse merren parasysh këto kosto të supozuara për shpërndarje dhe furnizim me energji elektrike prej 1.35 c/kWh, kostoja totale për konsumatorët fundor shtëpiak është nga 3.61 c/kWh deri te 8.35 c/kWh. Duhet të theksohet se këto kosto janë vetëm një ilustrim i kostove të supozuara të sistemit për të shpjeguar ndikimet e mundshme të ndryshimit të struktues tarifore.

Duke u bazuar në të dhënat e përlogaritura në këtë dokument, të dhënat tjera të sistemit, përcaktuesve të faturimit të grupeve të ndryshme të konsumatorëve, sasisë së konsumit të energjisë elektrike nga konsumatorët shtëpiak, dhe supozimeve tjera, si ilustrim i një tarife mestare për konsumatorët shtëpiak pa asnjë kufizim që mund të imponohet si rrjedhojë e ndryshimeve të strukturës tarifore, mund të jetë rreth 6.08 c/kWh.

Mbajtja e disa elementeve të strukturës së tanishme tarifore do të mundësonte të kemi një ndryshim të tarifave mesatare. Varësisht nga vendimi përfundimtar për strukturën tarifore, tarifa për konsumatorët e rregulluar për konsum specifik në kohë specifike mund të jetë prej 3.61 c/kWh deri te 8.35 c/kWh. Struktura e tanishme tarifore, mundëson që disa tarifa të kenë vlera të afërta me kufirin e ulët prej 3.61 c/kWh (p.sh. konsumatorët që konsumojnë gjatë verës dhe gjatë natës), dhe disa tarifa tjera të cilat janë më të larta se 8.35 c/kWh (p.sh. konsumatorët që konsumojnë gjatë dimrit dhe ditës).

Në tabelën 7 janë paraqitur vlerat e faturës së energjisë elektrike në relacion 70% me 30% (TL me TU) duke mos e përfshirë TVSH.

Vlera e faturës së energjisë elektrike (pa TVSH)			
Relacioni TL=70% (tarifa e lartë) dhe TU=30% (tarifa e ulët)			
Konsumi	Me blloqe		Tarifa mesatare
	Sezona dimërore €	Sezona Verore	Vlera e tarifës (6.08 c/kWh)
200 kWh	10.86 €	8.44 €	14.43 €
400 kWh	22.77 €	16.96 €	26.59 €
450 kWh	25.75 €	19.09 €	29.63 €
600 kWh	34.68 €	25.48 €	38.75 €
800 kWh	51.94 €	37.85 €	50.91 €
1000 kWh	69.21 €	50.21 €	63.07 €
1200 kWh	86.47 €	62.58 €	75.23 €

Tab. 7: Vlera e faturës së energjisë elektrike pa TVSH për konsume të ndryshme me relacionin: TL=70% dhe TU=30%

SHTOJCA 1: TARIFAT EKZISTUESE ME PAKICË PËR KONSUMATORËT E RREGULLUAR

Grupi Tarifor	Niveli i tensionit të furnizimit	Elementi Tarifor	Njësia	Koha gjatë ditës	Të miratuara	
					Sezona e lartë	Sezona e ulët
					1 tetor - 31 mars	1 prill - 30 shtator
0'	220kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		182.53	
		Fuqia e angazhuar	€/kW/muaj		14.44	
		Energjia aktive (P)	€/kWh		2.23	
0	110kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		91.27	
		Fuqia e angazhuar	€/kW/muaj		6.09	6.09
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	7.07	2.09
			€/kWh	Tarifë e Ulët	2.94	1.72
Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.00	0.00		
1	35kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		12.07	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		6.33	6.33
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	7.39	3.20
			€/kWh	Tarifë e Ulët	3.91	2.88
Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.72	0.72		
2	10kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		4.99	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		5.45	5.45
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	8.28	3.69
			€/kWh	Tarifë e Ulët	4.46	3.36
Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.72	0.72		
3	0.4 kV Kategoria I (konsumatorët e mëdhenj të energjisë reaktive)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.81	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		3.17	3.17
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	9.20	5.11
			€/kWh	Tarifë e Ulët	5.80	4.82
Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.72	0.72		
4	0.4kV Kategoria II	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		3.18	
		Energjia aktive (P)	€/kWh	Tarifë e vetme	11.33	7.33
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	13.64	8.94
			€/kWh	Tarifë e Ulët	6.82	4.46
5	0.4kV matësi 2 tarifor (2-vlerësh, shtëpiak)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.27	
		Energjia aktive (P) për konsum:				
		<200kWh/muaj (Blloku i parë):	€/kWh	Tarifë e Lartë	5.05	3.63
			€/kWh	Tarifë e Ulët	2.54	1.81
		200-600kWh/muaj (Blloku i dytë)	€/kWh	Tarifë e Lartë	7.00	5.01
			€/kWh	Tarifë e Ulët	3.51	2.51
>600 kWh/muaj (Blloku i tretë):	€/kWh	Tarifë e Lartë	10.16	7.27		
	€/kWh	Tarifë e Ulët	5.07	3.65		
6	0.4kV matësi 1 tarifor (1-vlerësh, shtëpiak)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.27	
		Energjia aktive (P) për konsum:				
		<200kWh/muaj (Blloku i parë):	€/kWh	Tarifë e vetme	4.51	3.22
			€/kWh	Tarifë e vetme	6.24	4.46
>600 kWh/muaj (Blloku i tretë):	€/kWh	Tarifë e vetme	9.05	6.49		
7	0.4kV (shtëpiak pa matës)	Konsumi i vlerësuar:				
		<200 kWh/muaj	€/konsumator/muaj		23.41	
		200-600 kWh/muaj	€/konsumator/muaj		42.37	
>600 kWh/muaj	€/konsumator/muaj		71.40			
8	Ndriçim publik	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		3.18	
		Energjia aktive (P) për konsum:	€/kWh	Tarifë e vetme	9.17	9.17

Tarifa e lartë aplikohet prej orës 07:00 - 22:00 gjatë sezonit të lartë dhe prej orës 08:00 - 23:00 gjatë sezonit të ulët.

Konsumatori ngarkohet me energji reaktive mbi atë të lejuarën që korrespondon me $\cos(\Phi)=0.95$